



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Zyra e Kryetarit

Nr. 01/_____

Datë :18.01.2016

Në bazë të nenit 3, paragrafi 1.4 dhe nenit 8 pika (4) të Ligjit Nr. 04/L-144 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.35/ datë: 17 dhjetor 2012), për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 2 paragrafi 4, pika (4.2), neni 12 , 13, 14 dhe 15, të Rregullores së Qeverisë së Kosovës Nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, e në zbatim të vendimit paraprak të kuvendit të komunës Nr. 02/311, dt.23.11.2015, për iniciimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës (paluajtshme) publike të komunës, si dhe në pajtim me dispozitat e vendimit të kuvendit të komunës së Malishevës nr.02/283 dt.29.07.2014, për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës publike të paluajtshme të komunës,

Komisioni Vlerësues, në mbledhjen e mbajtur me datën 18.01.2016, shpallë:

K O N K U R S P U B L I K

Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë, të pronës së paluajtshme publike (tokës) komunale

I. IPET në shfrytëzim afatgjatë, jo më shumë se 40 (katërdhjetë vite) prona publike në emër të KK-Malishevës, në sipërfaqe prej **2.00,00 /ha, pjesa e** parcelës kadastrale: P-7231-0025-00408-0, me kulturë kullosë e klasit të 3-të, në vendin e quajtur, “ Palanka-Galina”, zona kadastrale Dragobil pronë publike në emër të Kuvendit të Komunës së Malishevës.

II. Destinimi i tokës, e cila është objekt i dhënies në shfrytëzim afatgjatë, është Investimi në kapacitete prodhuese të kapitalit privat, e që do të ndikon në zhvillimin ekonomik të komunës së Malishevës.

Kriteret e përgjithshme për dhënien në shfrytëzim të pronë publike si më lartë :

1. Interesi i përgjithshëm publik i Komunës,
2. Prona e paluajtshme, nuk është në kontest pronësor,
3. Është e lirë nga obligimet ndaj personave të tretë,
4. Nuk është në kundërshtim me Planin Zhvillimor të Komunës,
5. Plotëson kriteret e përcaktuara mjedisore,
6. I plotëson kushtet për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik,
7. Ndikon në rritjen e vlerës së pronës.

Kriteret e veçanta për vlerësimin e ofertave :

1. Oferta ekonomikisht më e favorshme,
2. Vlera e investimit sipas vlerës së kapitalit,
3. Numri i të punësuarve nga investimet sipas planit biznesit, me ndikime anësore pozitive.
4. Lloji i investimit, (duhet të ketë investime në përputhshmëri me kriteret ligjore, në prodhim dhe përpunim, me përjashtime të riciklimit dhe përpunimit të gomës dhe produkteve të sajë.).
5. Përfitimi financiar i komunës (oferta për dhënie në shfrytëzim të sipërfaqes së lartcekur, është **1 euro çmimi bazë**, ndërsa oferta me kapital investiv më të lartë, shprehur në planin investiv do të ketë përparësi).
6. Plani investiv duhet të jetë në pajtim me kriteret mjedisore (Pëlqimi Mjedisor).

-Të gjitha dokumentet e kërkuara sipas kriterëve të veçanta duhet ti bashkëngjiten ofertës me rastin e aplikimit-dorëzimit sipas këtij konkursi, në dy kopje fizike (origjinali dhe kopja).

III. Të drejtë pjesëmarrje dhe konkurrimi, kanë të gjithë personat fizik dhe juridik të Republikës së Kosovës, si dhe personat fizik dhe juridik të regjistruar edhe jashtë Republikës së Kosovës, por që veprimtarinë e tyre e kanë të regjistruar në ARBK.

IV. Konkursi Publik do jetë i hapur 45 ditë:

Nga data, 18.01.2016 (dita e shpalljes në Web-faqen e komunës së Malishevës, tabelën e shpalljeve të komunës së Malishevës dhe gazetën ditore), dhe i njëjti do të jetë i hapur, deri më datë, 02.03.2016 ora 12:00.

V. Tërheqja e aplikacioneve - kopje fizike mund të bëhet në QSHQ (Qendra për Shërbimin e Qytetarëve) në hyrje të objektit të ri Komunës, çdo ditë pune nga ora 9:00 deri 15:00.

VI. Të interesuarit mund të informohen (çdo ditë pune) përmes:

Web – faqes së komunës së Malishevës : <http://kk.rks-gov.net> tel. +381 (029)269-008 , dhe e-mail adresës: komuna.malisheve@rks-gov.net.

VII. Personat e interesuar, mund ta shohin pronën, çdo ditë pune nga ora 9:00 deri në orën 15:00 (me personel të autorizuar nga Komuna e Malishevës).

VIII. Hapja publike e ofertave bëhet me datë, 02.03.2016, në ora 14:00, në Sallën e Kuvendit të komunës së Malishevës

IX. Tërheqja e aplikacioneve sipas konkursit, mund të bëhet jo më vonë se tre (3) ditë para hapjes së ofertave.

Komisioni Vlerësues:
Kryetari i Komisionit për vlerësim
Ramadan Buzhala
